

BIBLIOTEKA

E

88H-1

2 85

GJIROKASTER

LILLEHHS

Preç
Zogaj

Emrat
tuaj

poezi

SHËR
285

PREÇ
ZOGAJ

Rashaj te
TËNËS JORGESHI

Emrat
tuaj

POEZI

22945



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Të shtunat e malësisë

Një e nga një me çap të lehtë
nuset vijnë te vendlindja,
dhe natyra krejt e blertë
befas vishet me shumë ngjyrë.

Njërës i rrezëllejnë ende stringlat,
tjetra është me barrë të parë,
tjetrën e heqin pas fëmijët -
xhevahirët më të rrallë.

Uji i Velës pushon së ecuri,
çdo gjeth, çdo pellg bëhet pasqyrë,
pa kursim si zogu këngën
e derdhin dritë nusërinë.

Özisööm e tonulta öT

Nuset trishtuan veç një tē diel,
kur ia thanë lotët vajzërimit,
tani malësia i ka nder,
kur vijnë si perla tē blerimit.

Indri i abita është kurrë i zvijzda
që qëndron prej sades vjetëj,
zgjedhur apo njezit e mërisht
qëllimi osjtë përmirësoj

Qëndro se norësqë villoj i lësh
dixpara rindë gjetet apo mështë obë
magjek ugoz, ia mësimi që
ndiqet e shih mëbush e

Poezia

E nGRE atë si gjë të rrallë
nga pluhuri i punës, nga miqësitë,
nga gjaku i pastër proletar,
nga djejet ku rriten fëmijtë.

Dhe jam i lumtur së pà ndier
një mijë ura hedh në çast,
si udhëtar i mirë në derë,
në zemër njerëzve u trokas.

Këtu ku jam e jug veri
harkon një shatërvan me fjalë,
si urë ku ecim unë dhe ti
me një atdhe, një ideal.

Kohët më të bukura

Ë shkuara ka dhritë, po jo sa të më skllavërojë,
kohët më të bukura gjithmonë janë tani.

Shikoj oborrin e gjallë të gjimnazit,
ku vajza e panjohur dredhon me jekun,
malli im e ndjek dhe një djale tjetër...
Po nuk them: Ç'u plakat!
Nuk them: Bubull vajtai!
Kohët e bukura kanë vrapuar me mua,
kohët e bukura gjithmonë janë tani.

Pranverë

Gjithnjë i kam besuar fordës që buron nga toka,
po asnjëherë më shumë se në pranverë,
kur në trupin e lehtë e ndien jetën të bërë
edhe ngjyra lulesh, edhe këngë zogu.

Këpus një degë gjineshtë, sikur më shfaqet motra,
këpus një degë bliri, sikur më shfaqet nëna.
Këpus një degë molle, sikur më shfaqen shokët...
dhe farën e dashurive e paska ngrohur dheu.

Krejt njerëzisht sot atyre u shtrij dorën e burrit,
marr e jap me të fuqinë dhe bujarinë.
Zogu më afrohet, nxehësit nuk më druhën,
g'bëre me mua ti, avull i tokës, ti, brymë?

Mesazh pranverë

Në zërat-cicërima të nxënësve të mi,
në veshjen e tyre pothuajse të hollë,
m'u shfaq pranvera para kohe.

Pranvera afron; bregu- të lumit,
shoh ujërat të thyejnë akujt si qelqe.
Është shpejt - thonë fletët e mprehta të grurit,
është shpejt - thonë rrathët e erës në pellgjet.

Ku është pranvera? Ja, tek fëmijët
me atë veshjen pothuajse të hollë!
Në buzët e tyre zogjtë cicërojnë,
pranverën e sjellin në shkollë.

Ende është e bukur

Hapet pa pushim dera, hyjmë ne dhe jeta,
frym hidhërimin nga ballkoni.
Gjyshja na thotë: Flisni, qëshni,
vdekjen mos ma zemëroni!

E shoh dhe një valë malli më vjen të më lagë sytë,
sa dëshiroj ta shoh edhe një herë në këmbë,
të ulemi në zheg e t'i pushoj në shpirt,
si mbi një verë të paqtë e si mbi një legjendë.

Vdekja si vdekja ka nofulla të liga,
pak nga pak e kafshon... Ç'po m'ia lodh pleqërinë.
E mund me durimin, e mban veç për vete
gjyshja ime ë'mirë.

Ende është e bukur,
kështu do të vdesë:
shtatore e bardhë... Sytë si trëndafila
do t'i mbyllë ngadalë sikur lypë ndjesë
për zemrën e ndalur kur t'i pushojë fryma.

Këngë dashurie për bukën

Nuk pjek bukë, s'qe shorti im,
po buka s'më ka zënë kurrë.
Kurrë s'ma fshehu ëmbëlsinë,
as kur paksa u dogj në furre.

Më gjithë këngën i rris nderin,
edhe dëgjo ti, hundëpërjetë!
Njerëzor është nderimi për bukën,
nderimi për prodhuesin vëtë.

Me gjithë këngën i rris nderin,
dhe prapë ta dua, prapë ta puth
bukën e thjeshtë e të përditshme,
dorën, o njeri prodhues!

Gjyshja

Rinia e saj, është në fushat e ishullit,
vallëzon sa-herë rritet gruri.

Tani gjunjët e kanë lënë.
Dhjetëra kilometra katrore mat në oborrin e
ngushtë,
herë-herë sytë e saj hipin mbi krahë
- pëllumbash
dhe ikin në viset e mallit.

Herë-herë më trazojnë ata sy të ndershëm,
shtrojnë një kalldrëm të butë brenda meje,
ecin shumë ngadalë sytë e vëmendshëm,

vërejnë e mësojnë të rejat e jetës,
dhe shumë ngadalë dëlin përsëri,
çlodhen në gjumë, në gjumë të mirë
ata dy sy.

Hapja e stinës së dasma

Sot hapen dasmat.
Pranvera gatoi gjithë llojet e ngjyrave,
nuset e vjeçme lindën fëmijët e parë,
u bënë fli te kokrat e kallinjve
rrënjet dhe kërcenjtë e grurit në arë.

Sot hapen dasmat.
Fëmijët mbajnë në duar sandalet e lara.
Presin nuset t'i veshin:
Nuset kërkojnë hidhërimet e fundit nga
të tradhtojnë buzët që duan të qeshin.

Kthiminë, se çdo ndonjë vajzë

Mbrëmja afron horizontin,
detin e largët, ishullin.
Malli që kam bëhet erë,
më afron gjithë vendlindjen.

Ishulli këndej, i gjelbër
me fyjt e hareshëm të tokës
vë në gjumë zogjtë dhe fëmijët...

Atje kam nënën time.

Hëna; del dhe hap qiellin,
undan unaza kallinje
dhe ngjall hijet e bimëve...

Atje kam motrën time.

Nën hijet e luleve, bimëve
rruzujt e djersës ndizen
dhe vështrohen me yjet.

Atje kam gruan time.

Fund shkurti

pejsazh

Natyra përgatitet të lindë.

Pranverën përgatitet të lindë.

Së shpejti lëvozhga e bardhë e shkurtit
një çukitje të lehtë do të ndiejë,
të lehtë, të rëndë, pastaj
pranvera do të lindë.

Nënës

1.

E di, moj, e di se ç'të ka jeleku që të hidhët,
kur përkulesh mbi vitët dhe sytë i mbyll
përgjysmë,

...Dhe shtyn paksa

të na bësh vend në mes
ne, fëmijëve...

Veshin e vë te zemra,
troket, përkundet si djepi.

Ngado fëmijët të ndjekin, i ndjell,
se djepi ynë ishte diku në krahërorin tënd,
te qumështi i gjirit, te gjaku i zemrës, nënë!

2.

Nënöke, jam rritur e më zë shpesh malli,
për një shuplakë të ngrohtë e të freskët,

për një copë gjumë në prehrin tënd.
Më zë malli për rininë tënde...

Dhe buka që ha, dhe gota e ujit
kanë djersën tënde.

Dhe shtati im, dhe sytë e mi, dhe koka ime
janë gjaku dhe dashuria jote.

Me një përkëdhelje, me një shikim

m'i fshin shenjat e burrërisë,

më kthen te fëmija, kthehet te nusja.

Vij dhe iki e nga dashuria
hedh sytë përreth e shoh Shqipërinë,
shtrij krahët e zë qindra miq,
me emrin tënd hap shumë porta...
Të faleminderit, nënë,
për këtë trashëgim të madh!

Dhe kudo qofsha në ecje, në pushim,
rrrokullisem, rrëzohem, ngrihem, bie
në djepin e duarve të plasura të nënës,
që më përkundin zemrën e burrit.

Herët në agim

Ma ka ënda të jem zgjuar më parë se ylli i
mëngjesit
të shuhet mbi sipërfaqen e ujit të ftohtë në pus,
dhe gruaja dhe unë bashkë me ujin, me kova nga
pusi ta nxjerrim,
të lajmë ftyrën me të si me sapun venus.

Ma ka ënda të jem në udhëtim, kur Vela e
zhveshur
të ngjan me një piramidë që agu vetes ia ngriti,
dhe ti ecën drejt saj si faraon i shkujdesur
pa kurrfarë misteri në vete, pa kurrfarë miti.

Ma ka ënda të jem dëshmitar i të gjitha agimeve,
të shpejtohet ai prej meje e prej të tjerëve,
mjalëses në stanicë e largët t'ia zbardhë mandilen,
dhe mua me zgjim të ma shuajë mallin njerëzor
nëpër deje.

Një katalogi

Një katalogi
dëshmorët e një djalilës së përmes lumenjve
ecja me pëllim qëndrueshëm
përfiton se lëviz vërmë e s'kupt jetë
as sërisht që qëndrueshëm

U rriten me shumë vërtetë
me fjalë, me fjalë,
Pashqitë e jashtëzakonetë gjithçka
dhe zotëzë e kësaj vërtetë
një vërtetë e një vërtetë
U vërtetë që vërtetë

Die vërtetë
do vërtetë
dihën vërtetë
dihën vërtetë

Si dëshmitar i shumëhershëm nuk kamasnje
fjalë të keqe,
gjer në oborr të shkollës më mua ka ecur si mik,
pastaj është futur pa ndier në fjalën time të
sjellshme,
në veskun e pastër të nxënësve, në faqet dhe në
sytye.

Një karafil...

Një natë arrita në një qytet, ishte vonë,
ecja me hijen dyfishe para e prapa,
kujtoja se isha vetëm e s'kish njeri
as zëra, as dritare të hapura.

Pashë një karafil si zgjaste gishtat e gjelbër
dhe gojën e kuqe me erë të mirë
nëpër mermerin e një statuje...
U afrova, pashë, njoha Vasilë.

Një karafil me erë të mirë
zgjatej mermerit me ledhatime.
T'i jap pak gjak pata dëshirë,
për dashuri, dashurinë time.

Ne dhe dëshmorët

lipel E

Njëzet e tetë mijë, një e nga një
ratë përsëri në zemrën time...

U rritëm me emrat tuaj në gojë,
me fjalët, me ëndrrat, me fotografitë,
u bëmë të njoħur e të dashur si shokë,
aq sa thamë: Do t'ju takojmë një ditë!

Dhe u takuam...
Jo veç te bustet madhështore,
duke i ndezur trëndafilat me mall të gjakut
buzëve,
idealini tuaj e zbritëm te duart rinore
dhe rinisëm nga rënia jetën tuaj të bukur.

Njëzet e tetë mijë, një e nga një
ratë përsëri në zemrën time...

Elegji

Bashkatdhetarëve të pushkatuar në kampet naziste — sipas tregimit të një veterani

Heshtjen - plumb e heq zvarrë,
toka më merr me të mirë.
I hedh akull po të qaj,
i hedh brymë po të shfryj.

Plagët e tyre i kam shëndosh.¹⁾
Njërin sy plumbi ua mbylli,
tjetri sy na sheh nga dheu,
kërkon, kushton një dorë martiri:
Shpjermani gjakun te atdheu!

1) i kam të gjalla.

Nadjejda i bisejda

Plagët e tyre i kam shëndosh.
Nënë, moj! Hape për djemtë
në buzagaz të prillit vërrin,
ta kenë që të zgjohen lehtë
kur lulet e beharit ngjallen.

Plagët e tyre i kam shëndosh.

Nënë, moj! Hape për djemtë
në buzagaz të prillit vërrin,
ta kenë që të zgjohen lehtë
kur lulet e beharit ngjallen.

Plagët e tyre i kam shëndosh.

Ndjenjë

Një zë i thellë natën jashtë
m'u bë se më thirri në emër.
Lashë bukën, gjellën lashë,
ndreqa flokët dhe dola,
s'ishte kush vec hëna...

... Më qe hapur zemra,
qe hapur ledhesh malli im.
I mërzitur hyra brenda,
hapa gjithë dritaret
të më ndiejë udhëtarë.

Ç'bisedojnë të dashurit

Mësimi është që përdor nuk
Të dashurit sjellin mijëra mesazhe
për njëri-tjetrin.

Nëse ka midis tyre pak zbrazëtirë,
është vendi i ligjshëm i fëmijëve.

Nën harkun e plepave...

Atje në rrugën Lezhë-Manati,
nën harkun e plepave të butë
vinte mbesa me një djalë të ri...

Ktheva blatishtës pa rënë në sy.

Dhe besova i hidhëruar
se ai më shumë se unë i shkonte në krah.
Gazi i saj më ftonte në gëzime,
po lufta, lufta u ndez e s'më la.

... Stërgjyshërit si erë dimri,
me mustaqet si brirë,
ku zemërimi bën folenë,
më shpuan në brinjë,
mërmëritën: Luaj!

Eduaruturët e Dëzidit Armë

lëshës së që është më i madhi
e përmes ne përcaptej atëqëjën lotë
të dhëratë që nuk ka përdorë e tëmujë
të marrë lëshës së që është më i madhi
së përmësuar që sot është zbuluar
Gjyshërit-gjëmime luftërash
e gjithashtu lodra grash
u ngjallën nëpër genet,
urdhëruan: Luaj!

Babai flokëborë
tha: mbaj frenat mirë,
në sytë që mbylli fshehu
një qeshje, një dëshirë.

Ikte mbesa me një djalë të ri...
Ktheva blatishtës pa rënë në sy.

Flamurtarët e Deçiqit

Përpara se të nisemi për në Deçiq,
e bëmë në heshtje vdekjen tonë:
Hëngrëm pak nga buka e fëmijëve,
pimë fshehur lotët për vejushat dhe jetimët,
shkundëm për zogjtë xhepat me thërrime...

Pastaj u pamë me flamurin,
me vdekjen bëmë benë e jetës së tij.

Kthejmë pak kokën. Gratë dhe fëmijët
nuk na lusin që të kthehem.
Këngët e rapsodëve na shpëtuan. Qysh tanë
nga një flamur kuq e zi do të jetëjeta jonë.

Armiqtë

(Sipas një kënge të vjetër mirditore)

Na kanë vrarë e na kanë prerë,
na kanë djegë e na kanë therë,
na kanë varë në çengel,
sytë lidh-o me shami!

Na kanë thyer djepet për gur,
na kanë vjedhë bukën në furrë,
na kanë shkruar keq në flamur,
shtatëqind kat krime hordhi!

I hedh deti-zi nga valët.
Lypin gjak e u falim varret.
U dridhen malet përmbi vajet,
thërresin: «Nano, ç'na ka gjetë!»

Artimi

(monogram i ciklo i Artimi Sipërm)

Në këtij mënyrë që këqitë
në këtij qëndrë e gjithë përfund
në përfundave të qytetit
të qytetit qëndroj

Në këtij mënyrë qëndroj
në këtij qëndrë tjetër qëndroj

Vit për vit... U shpall zakoni
me tha vera një pashë Stambolli.
Vit për vit po përkund shkrepit
fëmijët tanë që nuk kanë djep.

Peshkatari i vjetër

Rinia e tij e kaluar në det, hidhet e përhidhet mbi dallgët e serta, afrohet në breg e prapë e thërrret:
Eja t'i shtrojmë gollat e errëta.

Ai zërthen kopsat e këmishës dhe shfryn
afsh të ngrohtë dashurie e malli të vjetër;
zbuten baticat, deti psherëtin,
belbëzon si fëmijë i pafjetur në shekuj.

Prapë hidhet rinia e prapë i thotë eja,
e prapë mësyn sterenë vala me shkumë,
e prapë e merr gjakun për trup nga dy zemra
njëra rreh në gjoks, tjetra në flamur.

Mbrëmë fjeta mbi një tjetër

Mbrëmë fjeta mbi gurgullimën e një lumi të largët
i mbuluar me fijet e gjata të barit të bregut,
shtrirë mbi kurriz, me dy gishtërinjtë e ngritur si
gërmëtë e fallog ëmbla është që
duke prerë lojra nga pëlhura e erës.

Rrotull meje vërtiteshin rrathët prej shkume të
zgjata dorën t'i zë... dhe nuk zura gjë,
lumit iu mor gurgullima, fijet e barit humbën...

Unë u zgjova, në cepat e syve
ma mori gjumi vendlindjen.

Hyj në shtëpi

8891 101012

Hyj në shtëpi i lodhur nga puna,
çdo gjë këtu më fton miqësisht;
më ftojnë t'i çel dritaret e dhomës,
shkëlqejnë sendet si sytë e foshnjës,
gjallojnë e më përshëndesin miqësisht.

Dhe ja, pas sipërfaqes brilante të mobiljeve
unë shoh atje ku s'arrin drita
duart e zdrukthëtarëve, duart e bojaxhinjve,
djersën time e të nënës, vëllazëruar të gjitha.

Sjell këtu botën e madhe që fryshtë,
vij si nyje takimi mes fushës dhe dhomës,
duke i shembur me shpirt muret e trashë,
kufijtë punë-pushim ia fshij qenies dhe rrojtjes.

Shtëpia s'ka asgjë të huaj të më gënjejë,
shtëpia s'ka asgjë të vdekur të më trishtojë,
kthej në shtëpi si varka në molon e qetë,
plot me dëshira njeriu dal nga shtëpia i lehtë.

i shtator 1983

Hëンgra një copë bukë në këmbë duke parë orën,
vesha këmishën e re të një shtatorit,
i thashë njatjeta vetes në pasqyrë
dhe dola.

Ashtu harruar, harruar ndoqa udhën e shkollarëve...
Ku të kthehem? Ku të vete? Në një udhëkryq
zemra mbyll koncertet e një nate.

Regjistri im është mbyllur.

Larg, matanë shumë maleve,
fëmijët e Velës ma përmenden emrin.
Në dushkun më të lartë i ribien ziles,
sikur më thonë: Si ike, si ike!...

Seriku ose dëmollitona u këndëmton e tjetë. Në
fushë i lëkqit qëndron fushë mësuesi
njëra me një tjetër që është e vërtetë
një mësues. Dëshiron që mësuesi
të përfundoj me këtë.

“Të përfundoj me këtë. Të përfundoj me këtë.
Të përfundoj me këtë. Të përfundoj me këtë.
Të përfundoj me këtë. Të përfundoj me këtë.”

Zemra më rreh si zemër fëmije,
kur mësuesi i këngës bërtet: Pa fjalë!
Në orën e parë lagem nën një palmë,
veshur si për festë sa për të lozur me veten,
përgjegjësi i zyrës do ma falë vonesën.

Motra

Një pirg këmishësh e pantallonash me djersë
ia kam lënë motrës pér t'i larë.

Në sytë e saj disi të heshtur,
në veshjen dhe sjelljen aq të shkujdesur,
në flokët e pakrehur... e di se jam vëlla.

Sot po i lan, po i këndon aq mirë
dhe unë ashtu kot vështrova prillin në pjeshkë,
e kuptova. Diku e dashuruar ishte.

Pandeva se do më këputej fryma
nga një mall i brishtë...
Këputa një degë me delikatesë miku
dhe u fsheha pas saj.

Motër, sa pak flet ti!
Ajo qeshi dhe në sytë e saj
vëllai më i bukur isha.

Si dashur si bukur
Sa do të doja tani
t'i dal përpara vashës sime.
I dashur si asnëherë tjetër,
i bukur si asnëherë tjetër.

Eppur si muove

Kur flakët e zjarrit të Vatikanit
me gjuhët si shpata iu kanosën Galileut,
«S'ndreqet me vdekje, i tha papatit,
Eppur si muove¹⁾ lëmshi i dheut».

Eppur si muove — gjëmon zëri i historisë,
Eppur si muove — këndon revolucioni, lufta.
Perënditë në hauret e ngushta, nga lart i sheh
njeriu punëtor i mijërafishuar te puna.

1) Megjithatë rrotullohet

Imazhe

I vika erë kulloshtër këtij gjethi,
nuk mund, vëlla, nuk mund të eci.
Në tokë lë çantën me librat e gjuhës,
kërkoj fëmijërinë nëpër erën me qumësht.

Me se ta ndaloj, me se ta ndjell?
Prej mallit dua të shtie me pushkë,
si ngrihen zogjtë e tokës në qiell,
zë del ajo nga era me qumësht...

Për një burokrat

Në udhët e bukura me shpejtësinë e erës
ik e ik xhipsi, merr malet përpjetë,
vrapin e ndal përpara minierës,
nga dera e parë zbret një burrë i sertë.

Jo kështu, po ashtu, me ngut u thotë atyre
që udhët e nëntokës pas pak kanë për të marrë.
Vrik e vrik lëshon urdhrat, qortimet dhe
kushtrimet,
përderisa ia mban koka, kurrizi i tyre mban!

Po atje në minierë ata që nxjerrin bakrin,
pas tetë orësh punë do kenë dhe ca të tjera,
siç flaket lënda e huaj që rrëthon mineralin,
ta flakin burokratin nga radha, nga ndërgjegja.

Një njeri

Më queshte nga larg, më queshte nga afër,
më fuste krahun e më ftonte pér kafe.

Mbante erëra të mira sapuni,
erëra stofi të kombinateve tonë,
ashtu i futur në bukurinë e tyre,
më bënte ta doja e ta dëgjoja.

Dhe ja se ç'deshste: Ta lija në klasë
vajzën e fqinjit që humorin ia prishte,
se gjuha e tij na grika pa masë.

E pashë i nxehur me një dhembje në shpirt:
sa shumë shpenzime që të mos dukesh i lig!

Në jetë jam

Në jetë jam në bisedë me fshatarin,
kur flasim për foshnja, për tokë e të korra.
Gjithnjë nga e vogla formohesh e madhe,
botë moj, udhëpasosura.

Për hatër të këngës s'e dua qetësinë,
ajo ma lëndon bukurinë e shpirtit,
në jetë jam kur e kërkoj bukurinë
te njerëzit që njoh,
te mundi i krijimit.

Ra nata

Ra nata e thellë, në udhëkryqë valësh
u kacafytën lajmet e fundit me psallmet.

Më mërzit me shtrirjen e saj kjo qetësi,
një zë më thotë: Zhvish rrobat dhe fli!

Unë dua, po s'mundem, nuk mundem vërtet,
diç kam për të thënë për ty, moj jetë.

Kaq dua të rroj, kaq për zemër të kam,
sa dhe gjumin më dhimbet ta marr.

Bisedë

Ka një jetë që mund të më jepet,
je ti. A më ndien?

Dora flet fjalët e ujit që fshin gurin,
gjuha lidh e zgjidh fjalë të bukura,
po në trup e në tesha s'mbaj erë mendre.
Jam familjar me hallet e tokës,
u jam shfaqur me ngut njerëzve
si binjak i zellit të tyre.

Më ndien ti?

Dashuroj lehtë si flladi,
fuqishëm si dallga,
jam një njeri, i sakrifikuveshëm
për një shok, për një fije bari.
Nuk e arrij me duar, veç me shpirt popullin,
nuk dëshpërohem, të dua ty —
mirëkuptimi, mirëshikimi im,
emër i shkurtër i dashurive të mëdha.

Frym juga

Frym juga, frym mall,
më trazon shpirtin,
e shoh fytyrën e saj
nëpër flladet që ikin.

Ikën dhe vjen duke nxjerrë dritë
nga sytë, nga bluza e bardhë dhe e hollë,
duke ngritur natën e përgjumur nga plisat
jam zgjuar, them: A je brymë a borë?

Nuk ka asnje mister

Nuk ka asnje mister næ pyllin e bukur tē prillit,
eci nën pisha, nën thërrmiza dielli,
paksa i magjepsur bares si njeriu,
kur ndien se dhe zogjtë ia thërrasin emrin.

Padurimi, fërgëllimi duken si magjepsje,
duke u ndrydhur næ bujarinë,
duke u ndrydhur næ dëshirën time
për ta ndarë bukarinë e prillit me ju.

Dal në gur

Dal në gur e shikoj vajzat,
poshtë në fushë kanë qenë,
prapa tyre ecin dasmat
mbi kuaj ere dhe s'i zënë.

Ato më shohin dhe qeshin...

Paskan parë nusen time,
paskan parë fushën, detin.
Ç'kam të shtrenjtë në vendlindje.

Eca me buzëqeshjen time

Gjithë ditën eca me buzëqeshjen time,
thua jse të pashkak. E pse ta dija?
A duhet pyetur dita e prillit
pse i skuq trëndafilat?

Nga kurorat e pemëve si nga stacionet
vijnë e kalojnë ftyra të qeshura.
Ç'ka ndodhur, ç'është shkaku?
Ç'më ka, ç'të ka zemra?

A duhet pyetur dita e prillit
pse i skuq trëndafilat?

U deshëm të rinj

U deshëm të rinj, aq të rinj,
sa etërit s'na besuan.
Megjithëse dashuria s'qe një mrekulli,
krejt natyrshëm ne e krijuam.

Nga brigjet e Drinit, të patrembur ikim,
hijet që përgjojnë, rishtas janë kaçube,
këmbët e mia i frenon të ecin
ai zëri yt: Kujdes, janë lule!
Ulem t'i mbledh e s'mund t'i mbledh,
t'i këpus më është ndaluar,
më është ndaluar fjala me mend.
Për herë të parë jam i dashruar.

U deshëm të rinj — kaltëronin sytë tanë,
jeta pa sekrete shkruhej aty.
Atëherë pse të fshiheshim në hije të saj?
Përse të dashuroheshim pa na ditur njeri?

Zura një valle veriu

Zura një valle veriu në shesh,
tunden ndër pisha halat e holla,
do kërcej deri vonë, deri në mëngjes
të dridhet toka e të zgjohet belholla.

Pastaj do bëj sikur do vdes.
Të vijë ajo dhe njerëz të tjerë,
të hap sytë nga poshtë e të shoh qiellin,
si zall me gurë të bardhë
në mes fytyrën e bukur të saj...
Po i them vajzës: Të zura në vaj.

Këngë

Vij dhe vij te sytë e vashës,
përherë i dashuruar pas jetës.
Jam parë e krehur në ata sy,
jam zhytur i téri si në flakët e diellit,
ballë pér ballë, edhe larg shpeshherë, gjithnjë
se të ndieja pranë si shoqe udhe.

Përmes teje më mirë kam parë
përse është bërë njeriu:
Pér ta shpjeguar botën dhe pér ta
transformuar,¹⁾
përmes teje i pashë të lehta,
të bukura detyrat e mia.

1) Varg i Pol Eluarit.

Këngë e Lura një vallë veriu

Vjell që s'ndryshon,
Vjell që s'ndryshon,

Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,
Pra vjell që s'ndryshon,

Me se s'merret mendja,
ku s'mahnitet shikimi!

Këtë kohë, në këtë vend s'ka zbræzëti një çast,
edhe kur qepallat ulen mbi sytë me gjumë
pulsi i kohës në zemra rreh fort.

I pafaj në atë tetor

Ishte tetor, tetor i festivalit,
e kush nuk u deh nga këngët e vallet!

Atje kam njohur një gjirokastrite,
«Veri» më thirri ato pesë ditë tетори.
Veriut tim ia shtrydha gjithë ç'kishte
visare dashurie nga folklori.

Me folklorin e tij mund të shkohet
thellë shpirtrave të mirë pa zor fare.
Ai u merr mendjen babagjyshëve,
jo mos i mirrte mendjen e një vajze.

E largoj pendimin gjithsesi,
nuk kam qenë Veriu me folklor.
Kam qenë thjesht një mik, një njeri
i pafaj, besoj, në atë tetor.

I batjal ue ote tector

festive tector, tector I festival
e kump nuk u deh nga kenget e vallet!

festive tector, tector I festival
e kump nuk u deh nga kenget e vallet!

Ishter tector, tector i festivalit
e kush nuk u deh nga kenget e vallet! iA
.

hele nu s'k'wet
.
Keng et
.
Duket i

Pastërti

Shpresa e mire është që këtij vjet
dhe po nuk ka shkakit me këtë diku më e
qëndrueshme.

Një qell si ky, si xham përsipër fshatit,
një dimër e ca kam që s'e kam parë.
U shtrydhën retë me shi dhe furçë e flladit
kalon dhe fshin avujt dalëngadalë.

Shikoj përpjetë mos shoh diku fytyrën
dhe gati sa nuk shkas sipër përrenjve.
Atje mbi zaje dy buzë më përvilen
si çerdhe mes mirazheve të pemëve.

ithëtar

Atë krijon gëzimi që mbërrita:
te gjithë kjo dritë, te gjithë kjo pastërti.
Më duket buzëqeshje kam në gishta,
një pyll me drithërima kam në gji.

Sytë me dritë

Shpirti i mirë dhe fytyrën e ka gdhendur,
dhe sytë i ka mbushur me botë dhe me dritë.
Çdo njeri e ka një Olimp të ngritur në zemër,
jo Olimp pér zotat po pér dashuritë.

Me emrin dashuri e hedhim hapin, krahun,
na pasuronjeta shpirtin prej Shqipërie.
Qysh tani gjokset po të na i hapin
udhë, qytete, fusha, do mbulohen me xhevahire.

Sa shumë dashuri

Vjen marsi, dashuria të hollon si fije bari,
jonet e këngës tokën e zbusin.
Shikimi strehon katër stinë behari,
duart gjithçka që prekin e puthin.

Si qenka poeti, ja kështu është poeti,
kujdespaktë për vete, bujar te poezia.
Gjithmonë ditëbukuri, gjithmonë ditëshkreti
gati të këputet në mes nga dashuria.

Sa shumë dashuri për njerëz e tokë
farkëton pa pushim natë e ditë.
Ato ua jep njerëzve sikur t'u japësh forcë,
sikur t'u japësh shpirt.

Në moshën e burrit

Në moshën e burrit, kur petkut të fëmijërisë
i kanë mbetur vetëm kopsat në një sirtar,
ziejmë e përziejmë në tru natë e ditë
punët e përditshme, shqetësimet qytetare.
Më shumë punë kemi me tokën, më pak me yjet.
mrekullitë e përditshme janë ngjizur në gjak,
bukurisë i flijohem dhe vetë pak nga pak.

Nga se magjepsemi?

Jo një herë më ndal toka, kudo
ku çdo grimcë dheu është folëzë
e grurit, dashurive dhe magjepsjeve të mia.
Si fëmijë thërras: O nënë! Thërras
dhe toka më përgjigjet.

Sa shume dasilitud o nörlaom öN

PËRMBAJTJA

Të shtunat e malësisë	3
Poezia	5
Kohët më të bukura	6
Pranverë	7
Mesazh pranvere	8
Ende është e bukur	9
Këngë dashurie për bukën	10
Gjyshja	11
Hapja e stinës së dasmave	13
Kthimi	14
Fund shkurti	15
Nënës	16
Herët në agim	18
Një karafil...	20
Ne dhe dëshmorët	21
Elegji	22
Ndjenjë	24
C'bisedojnë të dashurit	25
Nën harkun e plepave...	26
Flamurtarët e Deçiqit	28
Armiqtë	29
Peshkatari i vjetër	31
Mbrëmë fjeta mbi një ëndërr	32
Hyj në shtëpi	33
1 shtator 1983	34

Motra	36
Eppur si muove	38
Imazhe	39
Për një burokrat	40
Një njeri	41
Në jetë jam	42
Ra nata	43
Bisedë	44
Frym juga	45
Nuk ka asnë mister	46
Dal në gur	47
Eca me buzëqeshjen time	48
U deshëm të rinj	49
Zura një valle veriu	50
Këngë	51
I pafaj në atë tetur	53
Pastërti	55
Sytë me dritë	57
Sa shumë dashuri	58
Në moshën e burrit	59

Zogaj, P.

Emrat tuaj. Poezi [Red.: P. Jorgoni.]
T., «Naim Frashëri» 1985.

64 f.

(B. m.) dhe

(B. v.) : 891.983-1

Z 85

Tirazhi 1500 kopje Format 70x100/32 Stash 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re,
— Tiranë 1985